

JOLANDA BIBAJ

FUNKSIONET E SINTAGMAVE NDAJFOLJORE

Gjuha, shprehet T. Topalli, është në gjendje të simbolizojë çfarëdolloj forme të eksperiencës njerëzore: mund të organizojë mendimet tona, të mbështesë progreset tona logjike e mund të hyjë edhe në mbretërinë e imagjinatës e fantastikës¹. Por mendimi artikulohet me anë të fjalëve, fjalive, frazave, të cilat janë objekt i sintaksës. Filologët e vështrojnë fjalinë (fjalën dhe thënien) jo vetëm si formë sintaksore dhe formulë metodike, por edhe si mjet i shprehjes së qëndrimit ndaj realitetit, si shprehëse e stilit në një shkallë shumë më të lartë se fjala². Por fjalët nuk organizohen vetvetiu, nuk janë vargje të thjeshta fjalësh, por janë të përbëra nga grupe fjalësh të cilat kanë një renditje hierarkike³. F. Koleci shprehet se përbërësit organizohen sipas një strukture rikursive, sipas teorisë që studion strukturën e përbërësve (X'), çdo përbërës është projektimi i një koke. Koka përfaqëson elementin qendror të përbërësit dhe i jep emrin këtij të fundit⁴.

Nëse marrim në shqyrtim shembullin nga Kadareja:

1) “*Për fat të mirë, kjo nuk ndodhi*”⁵, një fjali të tillë do të mund të rishkruhej me rregullat e gramatikës gjenerative, me anë të kllapave të etiketuara në këtë formë:

[SP[për fat të mirë][SF[kjo nuk ndodhi]]]

Një paraqitje e tillë e treguesve sintagmatikë me anë të kllapave të etiketuara, ka përparësi ndaj skemës së pemës, por lexohen me vështirësi⁶, kështu që do t’i referohemi skemës së pemës e cila tregon më mirë organizimin hierarkik të përbërësve sintagmatikë⁷.

Ndër funksionet që kryejnë ndajfoljet, është edhe ai i të modifikuarit të shkallës së mbiemrit ose të specifikojnë kuptimin. Ndajfolje si: *shumë, tepër, pabesueshmërisht, pafundësisht, jashtëzakonisht, pak, tepër,*

¹ Tefë Topalli, *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011, f. 37.

² Gjovalin Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 19.

³ Giorgio Graffi, *Sintaksa, strukturat e ligjërit*, 2003, f. 99.


⁴ F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Tiranë, 2001, f. 35.

⁵ I. Kadare, *Identiteti evropian i shqiptarëve*, 2006, f. 9.

⁶ Thoma Dhima, *Gjuha shqipe, sintaksa*, 2010, f. 37.

⁷ Sipas G. Graffit kryefjala mund të ketë kokë funksionale EPT, Graffi, *Sintaksa strukturat e ligjërit*, 2003, f. 267, po kështu edhe G. Turano në “Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes”, f. 47 shprehet se kryefjala gjenerohet në brendësi të sintagmës foljore, konkretisht në pozicionin e specifikuesit.

mjaftueshëm, mesatarisht, butësisht, etj. shprehin shkallën, d.m.th. një vlerësim të cilësisë së përshkruar nga mbiemri në vetvete.



2. Por gjestet e Evropës do të ishin më pas, **tepër të kursyera** për ta.⁸

Në gramatikën e Akademisë, ndajfolja përkufizohet si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që emërton një tipar të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim ose tregon shkallën e një cilësie a të një rrethane ose intensitetin e veprimit⁹. Ndajfoljet, zakonisht, përdoren pranë një foljeje, mbiemri ose ndajfoljeje tjetër¹⁰. Në bazë të funksionit që kryejnë në fjali ndajfoljet dhe mbiemrat klasifikohen në fjalë leksikore nga përmbajtja e tyre e pavarur leksikore¹¹.

Ndajfoljet, nga pikëpamja morfologjike, ndahen në **ndajfolje leksikore** si: *nesër, herët, fort* etj. dhe **ndajfolje të prejardhura** me prapashtesën -isht, -az(i) si: *krejtësisht, fortësisht, lehtësisht, rreptësisht, afërsisht*, këto ndajfolje kanë kuptime të veçanta, shpesh kanë vlerën e togut *në mënyrë + mbiemri* prej të cilit formohet ndajfolja si p.sh. **vetvetishëm**, (në mënyrë të vetvetishme)

3. **Vetvetishëm** midis kaosit, pa retorikë intriguese, pa u shtyrë prej askujt, shqiptarët treguan **qartë** se ndiheshin evropianë¹².

Duhet pasur parasysh që për të kompletuar më mirë kategorinë e ndajfoljeve në lidhje me funksionet sintaksore të tyre, u fut kategoria e re e ndajfoljores, më e gjerë se e ndajfoljeve. Me sintagmë ndajfoljore kuptohet një sintagmë që mund të zërë të njëjtin pozicion dhe funksion të njëjtë me atë të një ndajfoljeje si p.sh. **për fat të mirë** kundrejt **fatmirësisht**. Në këtë grup mund të kategorizohen:

a. Ndajfolje të mirëfillta: *mirë, keq, vonë, herët, kurrë* etj.

⁸ Kadare, *Identiteti evropian i shqiptarëve*, f. 24.

⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, botim i Akademisë së Shkencave, 2002, f. 357.

¹⁰ Po aty f. 357.

¹¹ Anila Kananaj cituar nga Doktorata *Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe*, f. 60.

¹² Kadare, *Identiteti...*, f. 10.

b. Disa grupe parafjalore me funksion ndajfoljor p.sh.: *në mënyrë absurde, në shoqërinë e librave*

c. Disa grupe me folje të zgjedhueshme p.sh.: *flet siç e kanë mësuar, bëje siç të ka thënë*

d. Disa grupe me folje të pazgjedhueshme (forma të pashtjelluara) p.sh.: *duke dalë me këtë shi, do të marrësh një të ftohur.*

Nga pikëpamja sintaksore, sintagmat ndajfoljore mund të klasifikohen sipas funksionit që kryejnë kundrejt strukturës së fjalisë: ato mund të kenë funksion adjunktival (rrethanor vendi, mënyre, qëllimi), funksion atributiv (përcaktor me bashkim) etj. Mund të ndajmë katër grupe kryesore të ndajfoljeve:

- I. Ndajfoljet që kryejnë funksionin e specifikuesve të SNd.
- II. Ndajfoljet e predikatit- quhen ndajfolje predikati ato që janë argument i foljes ose modifikojnë SF (ndajfoljet argumentuese)
- III. Ndajfoljet e predikatit të tipit specifikuese
- IV. Ndajfoljet e jashtme të predikatit

4. Sa më shumë që nënshkrimi i marrëveshjes së Shqipërisë shtetërore me Evropën po afrohej, **aq më fort** ndiheshin murmurimat¹³.

Në shembullin e marrë në shqyrtim vërejmë se ndajfolja **aq** shërben si intensifikues kuptimi i SNd *më fort*, kjo shprehet në një fjali të varur rrethanore e cila luan rolin e plotësit të sintagmës ndajfoljore. **Aq** nuk mund të jetë kokë e një sintagme ndajfoljore sepse nuk ka mëvetësi sintaksore¹⁴, ajo është specifikues, ose mund të luajë rolin e shkallës.

I. Si ndajfolje që kryejnë funksionin e specifikuesit të SNd citojmë shembullin e Kadarese:

5. S'kishin kaluar **veç disa orë** që avioni i kryekomisionerit evropian Barroso ishte ulur në aeroportin e Tiranës.¹⁵

Në këtë grup futen ndajfoljet e sasisë si: *pak, veç, disa*, etj. të cilat specifikojnë SNd dhe kryejnë funksionin e rrethanorit të sasisë.

II. Në grupin e dytë, ndajfoljet e predikatit, futen ato ndajfolje që rrjedhin nga një argument i foljes, apo ato që modifikojnë foljen. Këto i gjejmë në shembujt nga Kadare:

6. Eposi i Kreshnikëve, bën pjesë **natyrshëm** në arealin epik evropian, **midis** Digenis Akritasit, Nibelungun, Kënga e Rolandit, Këngëtimi i Sidit e Sagat Nordike.¹⁶

7. Ky i fundit, **qysh atëherë, natyrshëm** e zuri vendin e vet mbi tre besimet kryesore të shqiptarëve.¹⁷

¹³ Kadare, *Identiteti...*, f. 14.

¹⁴ Anila Kananaj, *Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe*, f. 72.

¹⁵ Po aty f. 14.

¹⁶ Kadare, *Identiteti...*, f. 22.

8. Pjetër Budi, Frang Bardhi, Gjon Gazulli, Pjetër Bogdani i botonin veprat e tyre dygjuhëshe në kryeqendrat kulturore evropiane, për t'i sjellë **fshehtazi** në Shqipëri ku shkrimi dhe shtypshkrimi shqip ishin të ndaluar.¹⁸

Brenda këtij grupi vërejmë se ka një ndarje: ndajfolje mënyre (natyrshëm, fshehtazi), ndajfolje vendi (midis), të cilat kryejnë funksionet respektive të adjunktëve (rrethanorëve të mënyrës dhe të vendit), që siç dihet nuk janë elemente të domosdoshme të fjalisë, por specifikojnë kuptimin e gjymtyrëve të tjera, ose janë përbërës të sintagmave foljore, ndajfoljore apo mbiemërore. SNd *natyrshëm* që përputhet me trupin e mbiemrave të formuar me prapashtesën -shëm, përdoret sipas shkallëve: pohore, krahasore apo sipërore.

III. Ndajfoljet e predikativit të tipit specifikuës i gjejmë në shembujt:

9. **Ende** nuk dihet nga kishte buisur kjo kundërkulturë.

10. Rilindja Kombëtare Shqiptare, **ende** pa u çliruar Shqipëria, po përpiquej t'ia hiqte kulturës dhe gjuhës së saj rrekat e robërisë.¹⁹

11. Studimet tona historike dhe etnografike nuk kanë folur **kurrë** për to, ngaqë, me sa duket, i kanë gjetur tejet poshtëruese për një popull. Dhe ato janë **vërtetë ashtu**.²⁰

12. Por gjuha do të ishte **prapë një, ashtu siç** ishte identiteti i popullit.

Në një vështrim të parë vërejmë se pozicioni i tyre është para dhe pas SF. Në tre shembujt e parë, SNd **ende** është përdorur në fjali në pozicion para-foljor, SNd **kurrë** në pozicion post-foljor me funksion adjunktival (rrethanor kohe), të cilat përveç aspektit kohor, i shtojnë SF aspektin mohor të shprehur nga folja, ndajfolja **kurrë** përforcon mohimin, në vetvete ajo është ndajfolje mohuese. Sipas Xh. Gosturani²¹, gjuhë si frëngjishtja, spanjishtja, greqishtja e re dhe gjuhët sllave quhen gjuhë polinegative sepse ndërtohen me disa elemente mohuese njëkohësisht. Edhe shqipja konsiderohet e tillë, sepse mohimi shprehet me disa elemente njëkohësisht. Sipas tij ndërtime të tipit: **nuk+folje+ndajfolje mohuese** janë tipike për shqipen, siç dëshmon edhe shembulli i mësipërm (nuk kanë folur kurrë)²².

Po në shemb. 11 SNd **vërtetë ashtu** shpreh një pohim, SNd tjetër **ashtu siç** kryen funksionin e rrethanorit të mënyrës. Kjo sintagmë është e përbërë nga ndajfolja përemërore *ashtu* dhe pjesëza *siç* e cila është specifikuës i ndajfoljes *ashtu*, por që së bashku kanë funksionin e përforcimit të pohimit, pra janë plotës të foljes.

¹⁷ Po aty f. 25.

¹⁸ Po aty f. 23.

¹⁹ Po aty f. 30.

²⁰ Po aty f. 29.

²¹ Xh. Gosturani, *Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij*, në SF, Tiranë, 1975/1, f. 77.

²² A. Kananaj i quan elemente me polaritet mohor ato ndajfolje që kërkojnë të realizohen patjetër me një pjesëz mohimi, Doktoratë *Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe*, f. 75.

Në shembullin që vijon, SNd **prapë një**, në të vërtetë ajo është modifikuese e SMb **një**, e cila në vetvete është përcaktor i kryefjalës **gjuha**, e kemi thënë edhe më sipër që ndajfoljet modifikojnë mbiemra, folje apo ndajfolje të tjera.

Në vijim të sprovës së Kadaresë do të analizojmë edhe ndajfoljet e jashtme të predikativit të cilat i ndajmë në:

- a) ndajfolje rrethore, që kanë vlerë për krejt fjalinë²³ dhe,
- b) ndajfolje fokusuese, të cilat kanë si funksion shtimin e një informacioni specifik

Në grupin e parë do të shohim ato ndajfolje të cilat marrin funksione rrethore si: rrethororit të vendit (shembulli 13), rrethororit të mënyrës (shemb. 14, i shprehur me gerund, 15 me SNd dhe specifikues të saj), rrethororit të sasisë (shemb. 16), funksionin e një fjalie të nënrenditur kundrinore (shemb. 15)²⁴ p.sh.:

13. Perandoria, **ashtu si kudo** në Ballkan, u përpoq të krijonte të tjera zakone, stil, vese, arkitekturë, muzikë dhe letërsi.

14. **Diku** ia dilte e **diku kurrsesi**.

15. Do të mjaftonte të kujtonim nxënësit dhe mësuesit e masakruar, kur kapeshin **duke mësuar** shkrim e këndim, në bodrumet e fshehta, për të kuptuar se **përse** gjuha shqipe u ngrit **më pas** në statusin e martirit dhe **përse** zuri vendin e një tempulli.²⁵

16. Pa shkrimin asnjë ngrehinë gjuhësore s'mund të mbetej **gjatë** në këmbë.²⁶

17. **Gjer këtu edhe** mund të pranohej, **madje** mund të quhej tepër e përparuar, për të mos thënë që Shqipëria mund ta paraqiste sot si dëshmi të habitshme të vizionit të saj të emancipuar për homoseksualizmin, dy shekuj përpara Evropës së sotme.

18. Muzika po orientohej **më fort se më parë**.²⁷

19. S'është fjala vetëm për mosmirënjohjen që shfaqet **aty-këtu**.²⁸

Shembujt e marrë në shqyrtim nga vepra e Kadaresë kryejnë mes të tjerash edhe funksionin e mjeteve të realizimit të kohezionit tekstual, duke i vendosur ato në raporte të ndryshme kundërshtore, shkak-pasojë, lejore etj. Këtë mund ta vërejmë në shembuj si:

²³ Sipas A. Kananajt, ndajfoljet *prandaj, andaj, megjithatë* hyjnë në grupin e ndajfoljeve të fjalisë, po aty f. 73.

²⁴ Sipas Gramatikës së Akademisë 2, fjalia e varur kundrinore mund të shprehet me folje a lokucione foljore që tregojnë të perceptuar mendor si: *kuptoj, mësoj, njoh* etj. f. 517.

²⁵ Kadare, *Identiteti...*, f. 27.

²⁶ Vërejmë edhe këtu elementet mohuese: *asnjë, s'* të cituara më lart si elemente me polaritet mohor-Kananaj dhe, mohim i dyfishtë-Gosturani.

²⁷ Kadare, *Identiteti...*, f. 42.

²⁸ Po aty f. 47.

20. Mund të dukej se mbreti Zog, në përpjekje për krijimin e myslimanit evropian, po kryente ca bëma që mund të dukeshin donkishoteske. Por s'ishte **fare ashtu**.

21. Ndërsa shekullit të XX po i afrohej fundit, një nga tragjeditë e heshtura, po ndodhte **mu në mes** të Evropës.

Lidhëza **por** në vetvete është lidhëz kundërshtuese, në këtë fjali ajo bashkë me SNd **fare ashtu** kanë funksionin e paraqitjes së mohimit, e cila kundërvë mendimin e shprehur në fjalinë pararendëse. Konektori *por* luan rolin e përmbyësës të idesë dhe riformulon idenë e shprehur më sipër²⁹.

Krejt fjalia është një fjali mohuese që nxjerr presupozimin semantik (bëma donkishoteske) dhe kundërvënien me faktin (që bëmat nuk ishin të tilla). Pra përveç funksionit sintaksor të përforcimit të mohimit, SNd **fare ashtu** ka si funksion edhe kundërvënien me fjalinë pararendëse, shërben si konektor që lidh në mënyrë gramatikore dhe logjike të dy fjalitë.

Me funksion lejor dalin edhe SNd si:

22. Por pakicës, **sado rrënjëse** të ishte, do t'i gjendej zgjidhja.³⁰

23. Ata i treguan Evropës se s'kishin³¹ **asgjë** kundër krishtëritit serb, e **aq më pak** atij evropian, ngaqë krishterimi ishte gjithashtu besim i tyre, vëllam i vjetër i myslimanizmit, **madje** krishterimi shqiptar ishte më i moçëm se ai sllav.

Në këtë shembull të marrë në shqyrtim dallojmë disa SNd me funksione të ndryshme; në SF *s'kishin asgjë kundër krishtëritit serb*, SNd **asgjë** del me funksion kundërvënës, SNd **aq më pak** del me funksion lejimi, kurse SNd **madje** ka funksion fokusues, jep një informacion shtesë mbi fjalinë, bën pjesë në ato që quhen ndajfolje të jashtme të predikatit.

Me funksion përmbyllës SNd del në shembullin nga Kadare:

24. Ai rebelim do të paraqitej si luftë për islamin e jo si luftë për liri. Si luftë kundër krishtëritit serb e jo kundër krimit serb. **Shkurt**, si luftë kundër qytetëritit evropian, në emër të një tjetër qytetërimi.³²

E përdorur në këtë kontekst gjuhësor, SNd **shkurt** ka funksionin e përmbylljes së mendimit të shprehur në dy fjalitë paraardhëse.

25. Gjëmimi i bombave sipër Jugosllavisë, ishte **njëkohësisht** një lajm i madh. Një lajm nga ata që i vinin Shqipërisë **një herë në një mijë vite**, e Evropës vetë, **një herë në shekull**.

²⁹ Për më tepër mbi konektorët lexo Lindita Gjata, *Mjetet gjuhësore që shërbejnë për të realizuar funksionin e argumentimit në shqipen standarde*, në Studime albanologjike 2011/1, f. 155-159.

³⁰ Kadare, *Identiteti...*, f. 41.

³¹ Në këtë shembull folja kam nuk është folje joakuzative sepse cakton rasë, ndryshe nga rastet kur ajo silllet si folje njëvetore, për më shumë lexo Ludmila Buxheli, *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*, Botimet albanologjike, Tiranë 2011, f. 212.

³² Po aty, f. 43.

26. Të gjendur **befas** në qendër të historisë evropiane, a mund të thuhet se shqiptarët i kapën përmasat e asaj që po ndodhte? **Vështirë** të thuash “jo”, por **po aq vështirë** të thuash “po”

Në këtë shembull vërejmë SNd të përdorura me funksion rrethanor kohe, mënyre të shprehur me ndajfolje të prejardhura me prapashtesën -isht, me lokucion ndajfoljor dhe me ndajfolje të formuar me konversion nga pjesorja.

Përfundime

Në këtë kumtesë u përpoqëm të vëmë në dukje disa nga funksionet e sintagmave ndajfoljore. Nuk ishte qëllimi ynë të merrnim në shqyrtim arsyet e përdorimit të tyre nga Kadare, ato ishin shembujt për të nënvizuar karakterin e SNd, funksionet e tyre sintaksore. Gjatë analizës vumë re që pjesa më e madhe e SNd dalin me funksion rrethanor, por edhe me funksione të tjera sintaksore si: funksione predicative të krejt fjalisë, shtesore apo përmbyllëse të mendimit etj.

Ju falënderojmë *përzemërsisht* (po e mbyllim me një ndajfolje vullneti).

BIBLIOGRAFIA

- A. Kananaj, *Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe* (nga punimi i doktoraturës).
F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Tiranë, 2001.
G. Graffi, *Sintaksa, strukturat e ligjërit*, 2003.
Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002.
Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009.
I. Kadare, *Identiteti evropian i shqiptarëve*, 2006.
L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor*, Shtëpia botuese Neraida, Tiranë, 2007.
L. Buxheli, *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*, Botimet albanologjike, Tiranë 2011.
L. Gjata, *Mjetet gjuhësore që shërbejnë për të realizuar funksionin e argumentimit në shqipen standarde*, në Studime albanologjike 2011/1.
R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*,.
T. Topalli, *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011.
T. Topalli, *Sintaksa e fjalisë*, Shkodër, 2011.
Th. Dhima, *Gjuha shqipe, sintaksa*, 2010.
Xh. Gosturani, *Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij*, në SF, Tiranë, 1975/1.

